





la Biennale di Venezia

16. Mostra
Internazionale
di Architettura

Partecipazioni Nazionali



HAPĒSIRA
ZEROSPACE
ALBANIAN PAVILION 2018

FOREWORD

Commissioner
Mirela Kumbaro

4 FJALË
PËRSHËNDETËSE

EUTOPIIC TIRANA

Elton Koritari

6 TIRANA EUTOPIKE

A PHENOMENOLOGICAL PROJECT

Jurtin Hajro

12 NJË PROJEKT
FENOMENOLOGJIK

ZERO SPACE

Dorian Tytymçe
Florian Pollo

15 HAPËSIRA ZERO

SPACES TO PLACES

Egin Zeka
Fiona Mali

20 NGA HAPËSIRA NË
VENDE

+

Street Life | Jeta në rrugë

Vanessa Norwood

Ground floor change of use across Tirana

Ndryshimi i përdorimit të katit përdhes në Tiranë
Ilir Nase

A Thousand Piazze | Një mijë Piacca

Pier Paolo Tamburelli

The Zero Paradox | Paradoksi Zero

Denada Veizaj
Gjergj Islami

Our Zero Space | Hapësira Jonë Zero

Fablab Tirana + commonsense.studio + VARKA architecture

A Thousand Piazzae

Pier Paolo Tamburelli

Between 1989 and now, the population of Tirana increased from around 200,000 to nearly a million. In the 1990s the city expanded onto the surrounding farmland with the addition of unplanned housing hastily constructed on plot of uncertain ownership. People from all over the country moved to the region between Tirana and Durres (an uninterrupted metropolitan field now called Durana), settling wherever they could. And yet there was some tenderness in the fury of this process of appropriation. The new buildings, at least at the beginning, were all extremely small. And they happened to colonize a city that, in its turn, was small too. In fact, for all the efforts of Fascism and Stalinism, and for all the heroics of the Cultural Revolution, Tirana in 1989 was a Lilliputian city. Buildings were never higher than four storeys and distances between blocks did not exceed 15 metres. As a result, a tree of a certain age was always taller than the tallest buildings, lending the city a familiar and rural tone, one that immediately denied the totalitarian ambitions of the architecture. The monumental role played

Njëmijë Piaca

Popullsia e Tiranës është rritur nga 200.000 banorë në vitin 1989, në thuajse një million banorë në ditët e sotme. Qyteti u zgjerua në vitet '90 drejt tokave bujqësore përreth tij; shtëpi pa planifikim u ngritën me shpejtësi në troje me pronësi të papërcaktuar. Njerëz nga gjithë vendi u vendosën ku mundën në zonën midis Tiranës dhe Durrësit (një fushë e pandërprerë metropolitane që tashmë quhet Durana). Megjithatë furia e procesit të përvetësimit kishte edhe një lloj brishtësie. Ndërtesat e reja, të paktën në fillim, ishin jashtëzakonisht të vogla. Ato kolonizuan një qytet që ishte gjithashtu i vogël. Pavarësisht përpjekjeve të fashizmit dhe stalinizmit, pavarësisht heroizmave të revolucionit kulturor, Tirana e 1989 ishte një qytet liliptut. Ndërtesat nuk kishin më shumë se katër kate dhe largësia mes blloqeve të tyre nuk i kalonte 15 metrat, ndaj edhe pemët e vjetra ishin më të larta se ndërtesa më e lartë. Qyteti morrte kështu një pamje të njohur dhe rurale, e cila kundërshtonte ambicjet totalitare të arkitekturës. Rolin

by trees inside of this urban landscape is proved by the fact that at the collapse of the regime the trees were brutalized as the only available emblem of power ready to be destroyed.

This remarkably tiny city-structure proved stronger than we might have expected, as it was not entirely replaced in recent years. Tirana is still made of an incredibly dense network of small streets and irregular buildings that produce a surprising geography of microscopic public spaces. This Lilliputian urban apparatus is made of thousands of public spaces that are never bigger than an apartment. Most of the times these spaces are just very minor constellations of objects: a chair and a tree, two chairs and three steps, a bench and a light pole, a fountain and a table, a telephone booth and a traffic light. These minimal still lives accumulate their minor urban potential because all the spaces at the ground floor are shops and because the large majority of the buildings (at least the ones that are older than 1989) have open stairs. In this continuous public domain, every object acquires an urban tone. A particular configuration of capitalistic enthusiasm (shopping everywhere) grafted on socialistic relics (open air distribution spaces everywhere) determines a paradoxical public space.

This microscopic cityscape is supported by the clarity (and the relative indifference) of the monumental structure of the city. In fact in Tirana urbanism operates in very basic terms; the micro-scale of the urban continuum and the monumental apparatus of the city are entirely separated. The brutal simplicity of this relation, with the axis and the series of monuments defined by Armando Brasini during the protectorate clearly separated from the city-fabric, determines a condition in which the new large scale transformations are all related to main axes, somehow protecting the evolution of the small-scale tissue. This clear distinction of monumental apparatus and everyday city, associated with a basic but not insensitive relation of the monumental axes to the landscape of the Tirana region

monumental që luanin pemët në këtë peisazh urban e vërteton fakti që pemët, me rënien e regjimit, e pësuan brutalisht si e vetmja emblemë e pushtetit që mund të shkatërrohej.

Kjo strukturë mjaft e vogël e qytetit rezultoi më e fortë se ç'pandehej, pasi nuk është zëvendësuar ende plotësisht. Tirana edhe sot përbëhet nga një rrjet tepër i dendur rrugësh të vogla dhe ndërtesash të çrregullta, të cilat formojnë një gjeografi të habitshme hapësirash publike mikroskopike. Kjo tërësi urbane lillipute formohet nga mijëra hapësira publike që nuk janë më të mëdha se një apartament. Këto hapësira janë më së shpeshti bashkësi të vockla objektësh: një karrige dhe një pemë, dy karrige dhe tre shkallare, një stol dhe një shtyllë ndriçimi, një shatërvan dhe një tavolinë, një kabinë telefoni dhe një semafor. Këto natyra të qeta minimaliste grumbullojnë potencial të vogël urban sepse të gjitha hapësirat në katin zero janë dyqane dhe sepse shumica e ndërtesave (të paktën ato të para 1989-s) e kanë hyrjen dhe shkallët e hapura. Çdo objekt në këtë zotërim publik fiton një ngjyrim urban. Konfigurimi i veçantë i entuziazmit kapitalist (blerja e gjërave kudo) që i mbivendoset relikeve socialiste (hapësira të hapura shpërndarjeje kudo) e bën paradoksale hapësirën publike.

Kjo situatë urbane mikroskopike mbështetet nga qartësia (dhe indiferenca relative) e strukturës monumentale të qytetit. Urbanizmi vepron në Tiranë në mënyrë shumë të thjeshtë; mikroshkalla e vazhdimësisë urbane është plotësisht e ndarë nga kompleksi monumental. Thjeshtësia e vrazhdë e kësaj marrëdhënieje (boshtet dhe monumentet e ideuara nga Armando Brasini gjatë kohës së protektoratit janë të ndara nga indi urban i qytetit) bën që transformimet e reja të mëdha të lidhen me boshtet qendrore, duke mbrojtur disi evolucionin e thurjes në shkallë të vogël. Kjo ndarje e qartë e kompleksit monumental nga qyteti i përditshëm, shoqëruar me një raport të thjeshtë por jo të ftohtë mes boshteve monumentale dhe peisazhit të zonës së

(in this respect Tirana operates as a sort of Washington), determines an extremely practical city-model, where the micro-scale evolves in an extreme version of urban laissez-faire and yet the administration still maintains the capacity to influence the growth of the city by operating only on the monumental structure. So a characteristic balance of public and private energy finds a way to protect an extremely delicate urban tissue.

For all its spontaneity, the evolution of the Lilliputian city was not automatic. Planners at least did not destroy the richness of this micro-city (and it would have been fairly easy!). Without being too easily apologetic, it is reasonable to say that Albanian politicians and Albanian planners at least had a sense for this city and they did not make the mistakes that would have compromised its evolution. Certainly the micro-scale of the city was preserved because of the complexity of the distribution of properties (in Tirana real estate is an adventure, and not necessarily with an happy ending), and yet this quality of the city was also intentionally protected. There has been a project for public space in Tirana in the last twenty years, and (with all its shortcomings) it was at least a realistic and sensitive one. It was also a fairly basic and commonsensical project, one of tautological clarity: let's treat monuments as monuments and public space as public space! It is no big surprise that, contrary to a lot of sophisticated nonsense, this one did not fail.

Tiranës (dhe këtu Tirana sillet njëfarësoj si Uashingtoni) përcakton një model tepër praktik të qytetit, ku mikroshkalla zhvillohet deri në versionin ekstrem të "laissez-faire" urban, e megjithatë administrata ka ende në dorë të ndikojë tek rritja e qytetit duke vënë në punë vetëm strukturën monumentale. Pra ekuilibri karakteristik i energjisë publike me atë private gjen mënyrën të mbrojtë një ind urban jashtëzakonisht të brishtë.

Evolucioni i qytetit liliptut ishte spontan, por jo automatik. Planifikuesit të paktën nuk shkatërruan pasurinë e këtij mikroqyteti (që do të kishte qenë fare e lehtë!). Pa e tepruar me shfajësime, mund të pohohet se politikanët dhe planifikuesit shqiptarë u treguan të paktën të arsyeshëm dhe nuk bënë gabimet që do të dëmtonin zhvillimin e tij. Natyrisht mikroshkalla e qytetit u ruajt për shkak të shpërndarjes së ndërlikuar të pronës (pasuritë e patundshme në Tiranë janë aventurë me fund jo përherë të lumtur), por edhe kjo veçori e qytetit u ruajt qëllimisht. Këto 20 vite është hartuar një projekt për hapësirat publike në Tiranë, i cili (pavarësisht të metave të tij) është së paku realist dhe reagon ndaj realitetit. Projekti është gjithashtu mëse i thjeshtë dhe i bindet gjykimit të shëndoshë, me një kthjelltësi tautologjike: monumentet t'i trajtojmë si monumente, hapësirën publike si hapësirë publike. Nuk është çudi që, përkundër mjaft marrëzive të sofistikua, ky projekt nuk dështoi.

Pier Paolo Tamburelli

Architect, writer, and editor of San Rocco magazine in Milan. Having studied at the University of Genoa and the Berlage Institute Rotterdam, Tamburelli co-founded the Baukuh studio in 2004, currently based in Milan and Genoa.

Arkitekt, shkrimtar dhe redaktor i revistës San Rocco në Milano. Ka studiuar në Universitetin e Xhenovës dhe Institutin e Berlages në Roterdam, Tamburelli bashkë-themloi studion Baukuh në vitin 2004, aktualisht me seli në Milano dhe Xhenova.